

SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË

(ankimet nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09)

VENDIM
STRASBURG
31 korrik 2012

Në çështjen Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), duke gjykuar si Dhomë e përbërë nga:

Lech Garlicki, *president*
David Thór Björgvinsson
Päivi Hirvelä
George Nicolaou
Ledi Bianku
Zdravka Kalaydjieva
Nebojša Vućinic, *gjykatës*
dhe Lawrence Early, *regjistrues i seksionit*

Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 10 korrik 2012,
Shpall vendimin e mëposhtëm të miratuar në atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në tetë ankime (nr. 604/07, 43628/07, 34770/09) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituara në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (konventa) nga njëzet shtetas shqiptarë, M. Puto, S. Puto, K. Puto, S. Puto dhe A. Puto (nr. 604/07), B. Dani, F. Dani, Fi.Dani, B. Dani, Gj. Dani, V. Dani, A. Dani dhe Ad. Dani (nr. 43628/07), N. Ahmetas, M. Kreka, T. Kadiu, D. Kadiu, R. Kadiu dhe I. Kadiu (nr. 46684/07) dhe Sh. Muka (nr. 34770/09) përkatësisht më 16 nëntor 2006, 4 tetor 2007, 9 tetor 2007 dhe 18 qershor 2009.

2. Ankuesit u përfaqësuan nga Z. S. Puto dhe A. Tartari, avokatë që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në Tiranë. Qeveria shqiptare (qeveria e paditur) u përfaqësua nga agjentët e atëhershëm të saj, Znj. S. Meneri, Znj. E. Hajro dhe më pas nga Znj. L. Mandia nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Ankuesit pretendonin se kishte pasur një shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të konventës, si rezultat i moszbatimit të vendimeve administrative të formës së prerë që u jepnin atyre kompensim *në vend* të kthimit të pronave të tyre.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

A. Ankimi nr. 604/07: Manushaqe Puto

4. Ankuesit kanë lindur në 1925, 1925, 1929, 1958 dhe 1964. Të gjithë jetojnë në Shqipëri.

5. Më 27 korrik 1995 Komisioni i Vlorës njohu titullin e pronës së trashëguar të ankuesve ndaj një parcele toke 5,000 metra katrorë. Më tej vendosi që ankuesit të kompensoheshin në një prej formave të parashikuara me ligj.

6. Në vitin 1995, 1996 dhe 2002 ankuesit i dërguan shkresa të ndryshme Komisionit rreth çështjes së kompensimit, por nuk morën përgjigje zyrtare.

7. Më 30 mars 2007 Agjencia informoi ankuesit se ishte në procesin e përcaktimit të hartave të vlerës së pronës dhe alokimit të fondeve përkatëse. Rezultati do të hapte rrugën për vendosjen e kritereve mbi kërkesat për kompensim.

8. Më 6 tetor 2008 drejtori i Agjencisë vendosi *proprio motu* të verifikonte ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të Vlorës të vitit 1995. Deri tani nuk është marrë asnjë vendim tjetër dhe vendimi i Komisionit i vitit 1995 vazhdon të mbetet i pazbatuar.

B. Ankimi nr. 43628/07: Dani

9. Ankuesit kanë lindur më 1937, 1941, 1944, 1950, 1936, 1960, 1962 dhe 1968. Të gjithë jetojnë

në Shqipëri.

10. Më 31 tetor 1994 Komisioni i Lezhës njohu titullin e trashëguar të ankuesve ndaj një parcele toke 3,434 metra katrorë nga e cila 713 metra katrorë ishin kthyer. Ankuesit do të kompensoheshin për pjesën e mbetur 2,721 metra katrorë në një prej formave të parashikuara me ligj.

11. Në një datë të papërcaktuar ankuesit kundërshtuan vendimin e Komisionit para gjykatës, duke pretenduar se atyre duhet t'u kthehej një sipërfaqe më e madhe.

12. Më 10 dhjetor 1996 Gjykata e Rrethit Lezhë vendosi që ankuesve t'i kthehej një parcelë shtesë 1,187 metra katrorë. Si rrjedhojë, ankuesve iu kthye një sipërfaqe e përgjithshme 1,900 metra katrorë.

13. Megjithatë, deri tani atyre nuk u është dhënë kompensim në lidhje me pjesën e mbetur të pronës (1,534 metra katrorë).

C. Ankimi nr. 46684/07: Ahmatas dhe të tjerë

14. Ankuesit kanë lindur më 1928, 1932, 1948, 1949, 1953 dhe 1957. Të gjithë jetojnë në Shqipëri.

15. Më 19 janar 1996 Komisioni i Korçës njohu titullin e trashëguar të ankuesve ndaj një parcele toke 4,000 metra katrorë. Ai vendosi se meqë parcela e tokës ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një prej formave të parashikuara me ligj. Deri tani, ankuesve nuk u është dhënë ndonjë kompensim.

16. Më 15 janar 1999 Komisioni i Korçës njohu titullin e trashëguar të ankuesve ndaj një parcele toke bujqësore 59,546 metra katrorë. Ai vendosi se ankuesit do të kompensoheshin me obligacione shtetërore në shumën prej 1,018,236 lekë shqiptarë (LEK). Deri tani, ankuesve nuk u janë dhënë obligacione shtetërore ose ndonjë formë tjetër kompensimi.

17. Qeveria parashtroi se në vitin 2009 ankuesit aplikuan dhe morën kompensim në shumën prej 2,000,000 lekë në lidhje me 200 metra katrorë nga Fondi i Kompensimit Financiar (FKF). Nuk u paraqit asnjë dokument mbështetës.

D. Ankimi nr. 34770/09: Muka

18. Ankuesi ka lindur më 1926-ën dhe jeton në Shqipëri.

19. Më 7 qershor 1995 Komisioni i Tiranës njohu titullin e ligjshëm të ankuesve ndaj dy parcelave toke përkatësisht 63 metra katrorë dhe 597 metra katrorë. Më tej, ai vendosi se meqë parcelat e tokës ishin të zëna, ankuesi do të kompensohej në një prej formave të parashikuara me ligj. Komisioni njohu të drejtën e ankuesit për refuzimin e parë të dy godinave të ndërtuara në sipërfaqen e tokës.

20. Më 16 gusht 1995 Komisioni njohu titullin e trashëguar të ankuesit ndaj një parcele tjetër toke 800 metra katrorë, nga e cila 178 metra katrorë ishin kthyer. Ai vendosi se meqë 622 metra katrorë ishin të zëna, ankuesi do të kompensohej në një prej formave të parashikuara me ligj.

21. Në një datë të papërcaktuar, ankuesi paraqiti një kërkesë për kompensim pranë Agjencisë në lidhje me vendimin e Komisionit të datës 7 qershor 1995.

22. Më 23 shkurt 2009 Agjencia rrëzoi pretendimin për kompensimin me arsyetimin se ankuesi tashmë kishte përfituar nga kthimi i një parcele toke 178 metra katrorë. Brenda periudhës 30-ditore të njohur me ligj, nuk u paraqit asnjë ankim pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

23. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës shqiptare përshkruhen, *ndër të tjera*, në vendimin Qufaq Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë, nr. 54268/00, § 21, 18 nëntor 2004.

B. Ligjet për pronësinë

1. Ligji për pronësinë i vitit 1993, i ndryshuar

24. Ligji i parë mbi kthimin dhe kompensimin e pronave u miratua në 1993 (ligji nr. 7698 i datës 15 prill 1993 - "Ligji për pronësinë i vitit 1993", i ndryshuar). Ligji për pronësinë i vitit 1993 u përshkrua hollësisht në vendimet *Gjonbocari dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 10508/02, §§ 36-43, 23 tetor 2007, *Driza kundër Shqipërisë*, nr. 33771/02, §§ 36-43, 13 nëntor 2007, *Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 38222/02, §§ 23-30, 13 nëntor 2007. Ligji për pronësinë i vitit 1993 u shfuqizua me ligjin për pronësinë të vitit 2004.

2. Ligji për pronësinë i vitit 2004, i ndryshuar

25. Ligji për pronësinë i vitit 2004 synonte kthimin e pronave të paluajtshme urbane që ishin shpronësuar, shtetëzuar ose konfiskuar para datës 29 nëntor 1944. Në pamundësi të kthimit të pronës fillestare, ai parashikonte dhënien e kompensimit (seksionet 1, 2, 3 dhe 5).

26. Sipas nenit 13 kompensimi duhet të përcaktohej mbi bazën e vlerës së tregut të pronës. Ligji për pronësinë i vitit 2004, i ndryshuar, parashikonte gjashtë forma kompensimi: a) prona e të njëjtit lloj; b) prona publike e ndodhur në zona turistike; c) prona e ndonjë lloji tjetër; d) aksionet në ndërmarrjet shtetërore; e) vlera e pronës shtetërore gjatë privatizimit; dhe f) një shumë parash që i korrespondon vlerës

së atribuuar pronës në kohën e vendimit (seksioni 11, i ndryshuar).

27. Ligji për pronësinë i vitit 2004 fillimisht krijoi Komisionet vendore, vendimet e të cilave i ishin nënshtruar apelimit në Komisionin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (seksionet 15-17). Në vitin 2006 ato institucione u zëvendësuan nga Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (Agjencia) dhe zyrat e saj rajonale. Zyrat e Agjencisë Rajonale më pas u suprimuan. Aktualisht, Agjencia është organi i vetëm kompetent për të vendosur mbi kërkesat për kthim dhe kompensim.

28. Seksioni 23 i ligjit të vitit 2004 parashikonte krijimin e një fondi dhjetëvjeçar kompensimi, qëllimi i të cilit ishte ofrimi i kompensimit financiar. Më tej, ai njohu të drejtën e ish-pronarëve për të marrë kamatëvonesë që mbulonte periudhën nga njohja e të drejtës së pronësisë deri në dhënien e kompensimit financiar të llogaritur me normën mesatare vjetore të interesit të Bankës së Shqipërisë. Seksioni 28, i ndryshuar, parashikonte krijimin e Fondit të Kompensimit në Natyrë (IkCF).

29. Ligji për pronësinë i vitit 2004 është ndryshuar të paktën shtatë herë gjatë periudhës 2004-2010; afatet janë shtyrë në mënyrë të përsëritur. Ai përshkruhet më hollësisht në *Eltari kundër Shqipërisë*, nr. 16530/06, §§ 27-45, 8 mars 2011 dhe *Çaush Driza kundër Shqipërisë*, nr. 10810/05, §§ 18-36, 15 mars 2011.

30. Statistikat në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, të parashikuara nga qeveria, i bashkëlidhen këtij vendimi.

C. Praktika e brendshme përkatëse në lidhje me ligjin për pronësinë të vitit 2004, të ndryshuar

31. Në kontekstin e rishikimit të kushtetutshmërisë së legjislacionit pas hyrjes së tij në fuqi, në disa raste Gjykata Kushtetuese është kërkuar të vendosë nëse disa nga dispozitat e ligjit për pronësinë të vitit 2004 ishin në pajtim me Kushtetutën.

32. Në vendimet nr. 27 të 26 majit 2010 dhe 43 të 6 tetorit 2011, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi si të papajtueshme me Kushtetutën disa nga dispozitat e ligjit për pronësinë të vitit 2004, të ndryshuar, që autorizonin drejtorin e agjencisë qendrore të rishqyronte, anulonte dhe shfuqizonte *kryesisht* vendimet e Komisionit. Duke pasur parasysh, *ndër të tjera*, vendimet e kësaj Gjykate në çështjet Ramadhi dhe të tjerë, të cituar më lart, dhe Hamzaraj kundër Shqipërisë ((nr. 1) (nr. 45264/04, 3 shkurt 2009)), Gjykata Kushtetuese rikonfirmoi se “vendimet e Komisionit ishin të afta të vendosnin ndaj individëve pritshmëri ligjore të barabarta me atë të krijuar në bazë të një vendimi gjykate që njeh të drejtat e pronësisë të një individi”. Rrjedhimisht, ato vendime që nuk ishin akte administrative brenda kuptimit të këtij nocioni ligjor, ishin drejtpërdrejt subjekt rishikimi gjyqësor. Për më tepër, meqë këto vendime ishin bërë “përfundimtare dhe të zbatueshme”, nuk mund t’i nënshtroheshin rishikimit nga drejtori i agjencisë, i cili nuk “mishëronte karakteristikat e një organi gjyqësor ose organi quasi gjyqësor”.

Natyra e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

33. Ligji për Gjykatën Kushtetuese (ligji nr. 8577 i datës 10 shkurt 2000) parashikon se vendimi i saj është *erga omnes* dhe i detyrueshëm (seksioni 72 § 7). Vendimi hyn në fuqi datën e botimit të tij në Fletoren Zyrtare, përveç rasteve kur vendoset ndryshe (seksioni 26). Si rregull i përgjithshëm, vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar një akt si të papajtueshëm me Kushtetutën ose marrëveshje ndërkombëtare, prodhon efekt nga data e hyrjes së tij në fuqi (seksioni 76 § 1). Vendimi zbatohet me prapaveprim vetëm: a) në lidhje me një dënim penal edhe ndërsa është në proces ekzekutimi, nëse lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e aktit të shfuqizuar; b) në lidhje me çështjet që janë duke u shqyrtuar nga gjykatat e brendshme, për sa kohë që nuk është marrë një vendim i formës së prerë; dhe c) në lidhje me pasojat, që nuk janë shkaktuar ende, të ligjit të shfuqizuar.

D. Aktet kryesore nënligjore zbatuese në lidhje me ligjin për pronësinë të vitit 2004, të ndryshuar

34. Sipas ligjit për pronësinë të vitit 2004, të ndryshuar, qeveria ka miratuar disa akte nënligjore me anë të vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) të përshkruara më poshtë.

1. VKM-ja mbi dhëniet e kompensimit financiar

35. Në periudhën 2005-2011 autoritetet nxorën 6 VKM në lidhje me dhënien e kompensimit financiar ish-pronarëve (shihni *Çaush Driza* të cituar më sipër, §§ 38-43). Më 2005-ën kompensimi financiar u dha në lidhje me kërkesat për kompensim që rridhnin nga vendimet e komisioneve të Tiranës dhe të Kavajës. Më 2007-ën grupi i përfituesve u zgjerua, për të përfshirë ish-pronarë, të cilët ishin në zotërim të një vendimi Komisioni të nxjerrë në lidhje me qytetet për të cilat ishte miratuar dhe lëshuar një hartë e vlerësimit të pronës. Më 2008-ën, 2009-ën dhe 2011-ën të gjithë ish-pronarët që kishin të drejtë të kompensoheshin, pas një vendimi të Agjencisë Rajonale/Komisionit, plotësonin kriteret për të kërkuar kompensim financiar. Rezultoi se në 2010 nuk u miratua asnjë vendim.

36. Sipas VKM-ve të miratuara në periudhën 2005-2009, një ankues e drejta e të cilit për kompensim ishte njohur në lidhje me të gjithë pronën, duhet të paraqiste një kërkesë standarde për kompensim financiar pranë agjencisë qendrore, Tiranë, duke dhënë, ndër të tjera vendimin e Agjencisë Rajonale/Komisionit që njihte të drejtën e tij për kompensim. VKM-ja e vitit 2009 parashikonte më tej se një ish-pronar kishte të drejtë kompensimi financiar, me kusht që ai/ajo të mos kishte përfituar nga: a) ndonjë kompensim i mëparshëm; b) kthim i pjesshëm i pronës; c) e drejta për refuzim fillestar; d) zbatim i ligjit mbi shpërndarjen e tokës (ligji nr. 7501 i 19 korrikut 1991). VKM-ja e vitit 2011 deklaronte se një ankues që zotëronte një vendim të zbatueshëm dhe të formës së prerë, në lidhje me të cilin nuk i ishte dhënë asnjëherë kompensim, kishte të drejtë të përfitonte nga dhënia e kompensimit.

37. Kërkesat duhet të shqyrtoheshin në rend kronologjik mbi bazën e datës dhe numrit të vendimit të Agjencisë Rajonale/Komisionit. Gjatë periudhës 2005-2009 shumica e kompensimit financiar që duhet të llogaritej mbi bazën e hartave të vlerësimit të pronës, kufizohej në një vlerë maksimale 200 metra katrorë. VKM-ja e vitit 2011 krijonte një sistem të lidhur sipas të cilit shumica e kompensimit duhet të ishte si më poshtë: a) ekuivalentin e 200 metra katrorë në lidhje me pronat deri 1,500 metra katrorë; b) ekuivalentin e 300 metra katrorë në lidhje me pronat midis 1,500 dhe 3,000 metra katrorë; c) ekuivalentin e 400 metra katrorë në lidhje me pronat midis 3,000 dhe 5,000 metra katrorë; d) ekuivalentin e 500 metra katrorë në lidhje me pronat midis 5,000 dhe 10,000 metra katrorë; e) ekuivalentin e 600 metra katrorë në lidhje me pronat mbi 10,000 metra katrorë.

38. Paraqitja e një kërkesë përfshinte pagesën e një tarife shërbimi. Ankuesit të cilëve nuk u ishin pranuar kërkesat për kompensim financiar në një vit pararendës duhet të riparaqisnin kërkesën e tyre në vitin(et) e ardhshëm/e pasi të kishin paguar tarifën e shërbimit. VKM-ja e vitit 2011 i përjashtoi ankuesit nga pagimi i tarifës së shërbimit, në rast se riparaqisnin kërkesën e tyre për kompensim.

2. VKM-të mbi hartat e vlerësimit të pronës

39. Në periudhën 2007-2008 qeveria miratoi dhe lëshoi harta të vlerësimit të pronës që përfshinin çmimin referues për metër katror në të gjithë vendin (shihni *Çaush Driza*, të cituar më lart, §§ 44-45). Këto harta përdoreshin për llogaritjen e vlerës së pronave të shpronësuara dhe më pas të shumës së kompensimit financiar që duhet të jepej (krahasoni me paragrafin 26 më lart).

3. VKM-të mbi kompensimin në natyrë të ish-pronarëve

40. Ligji për pronësinë, i vitit 2004, i ndryshuar, parashikonte krijimin e IkCF-së (shihni paragrafin 28 më lart). Në periudhën 2007-2008 qeveria ka miratuar disa VKM mbi procedurat për shpërndarjen e pronave të mbuluara nga IkCF (shihni *Çaush Driza*, të cituar më lart §§ 46-52).

E. Plani i veprimit

41. Në vendimin nr. 350 të datës 29 prill 2011, Këshilli i Ministrave miratoi një plan veprimi për trajtimin e çështjeve të identifikuar nga kjo Gjykatë në vendimet e saj *Driza* dhe *Ramadhi dhe të tjerë*. Plani i veprimit ia atribuonte moszbatimin e vendimeve të formës së prerë sa më poshtë:

“...çështjet e hasura deri tani lidhen me mungesën e koordinimit ndërinstitucional në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe ndëroperueshmërinë e arkivave të këtyre institucioneve (...) Legjislacioni i pronësisë është i copëzuar dhe duhet të konsolidohet dhe thjeshtohet, me qëllim parashikimin e procedurave të thjeshta dhe transparente të kompensimit. Procesi i regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme në të gjithë vendin nuk kishte përfunduar ende. Nuk ekzistonte një hartë kombëtare e unifikuar prone. Agjencia nuk ka një bazë të unifikuar të të dhënave të vendimeve (...) Procesi i legalizimit nuk kishte përfunduar ende dhe identifikimi i pronave që do të bëheshin pjesë e Fondit të Kompensimit në Natyrë, nuk kishte përfunduar.

“...[Qeveria], duke marrë parasysh pritshmëritë e ligjshme të pronarëve për shumë vjet, shprehu synimin e tyre për dhënien e shumës së kompensimit 100%.”

42. Plani i veprimit përshkruante dy skema kompensimi.

1. Skema kalimtare e kompensimit

43. Skema kalimtare e kompensimit do të zbatohet në vitin 2011 (shihni paragrafin 37 më lart për informacione më të hollësishme).

2. Skema përfundimtare e kompensimit

44. Skema përfundimtare e kompensimit do të hynte në fuqi në vitin 2013, pas llogaritjes së faturës së përgjithshme financiare. Skema përfundimtare do të mbështetej në të dhëna digjitale hartografike dhe juridike të përgatitura nga Agjencia për Përgatitjen e Hartave Standarde. Një ankues që zotëronte një vendim të zbatueshëm të formës së prerë do të duhet të paraqiste një formular për të aplikuar për

kompensim. Regjistrimi i formularit të paraqitur në një bazë të dhënash elektronike do të kryhej në rend kronologjik mbi bazën e datës së vendimit të Agjencisë/Komisionit. Një ankues që zotëronte më shumë se një vendim të zbatueshëm të formës së prerë duhet t'i paraqiste në rend kronologjik. Shuma e kompensimit duhet të paguhej e plotë dhe me këste.

45. Autoritetet duhet të ruanin diskrecionin në lidhje me llojin e kompensimit që do të jepej. Ankuesit nuk do të kishin të drejtë të zgjidhnin një lloj kompensimi ndaj një tjetri. Nëse një ankues refuzonte llojin e kompensimit të dhënë, ai do të humbte të drejtën e tij për kompensim në lidhje me këstin përkatës. Kompensimi duhet të kryhej automatikisht nga autoritetet. Kompensimi në natyrë do të kishte përparësi ndaj kompensimit financiar. Deri në shpërndarjen e plotë të pronave për IkFC, e cila duhet të përfundonte deri më 2018-ën, kompensimi në natyrë duhet të shpërndahej sapo të vihej në dispozicion.

46. Një drejtori e re që do të koordinonte organe të ndryshme shtetërore u krijua pranë Ministrisë së Drejtësisë.

47. Plani i veprimit nuk përmbante afate kohore në lidhje me zbatimin e tij.

F. Ligji i fondit të veçantë të kompensimit

48. Më 25 shkurt 2010, Parlamenti miratoi ligjin e fondit të veçantë të kompensimit (*ligji nr. 10 239*) që është një fond i veçantë brenda kuptimit të ligjit të buxhetit. Përfituesit e fondit të veçantë të kompensimit janë të dyfishtë: 1) ish-pronarët e drejta e të cilëve për kompensim njihej në bazë të ligjit për pronësinë të vitit 1993 dhe/ose 2004; dhe 2) ish-pronarët e drejta e të cilëve për kompensim njihej në bazë të ligjit të legalizimit (shihni seksionin "Ligji i legalizimit" më poshtë).

49. Të ardhurat e fondit të veçantë të kompensimit përbëheshin nga: a) alokimet vjetore nga Buxheti i Shtetit në përputhje me ligjin për pronësinë të vitit 2004, të ndryshuar; b) të radhuat që rrjedhin nga shitja në ankand e pronave shtetërore në lidhje me të cilat nuk është miratuar asnjë vendim mbi kthimin ose kompensimin; c) të ardhurat e nxjerra gjatë procesit të legalizimit të ndërtesave pa leje (shihni paragrafin 51 më poshtë); d) të ardhurat e nxjerra si rezultat i zbatimit të ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore; dhe e) donacionet.

50. Fondi i veçantë i kompensimit do të administrohet nga Agjencia.

G. Ligji i legalizimit (ligji nr. 9482 i datës 3 mars 2006 mbi legalizimin, planifikimin urban dhe integrimin e ndërtimeve pa leje; i ndryshuar me ligjet nr. 9786 të 19 korrikut 2007; 9895 të 9 qershorit 2008; 10099 të 19 marsit 2009; dhe 10169 të 22 tetorit 2009)

51. Më 3 mars 2006 Parlamenti miratoi ligjin e legalizimit, me qëllim rregullimin e ndërtimeve pa leje dhe shtesave që ishin ndërtuar në truall publik dhe privat në vitet '90 dhe në fillim të viteve 2000 si rezultat i zhvendosjeve të shpejta, të thella e të brendshme demografike. Ligji parashikonte transferimin e pronësisë së parcelës së tokës në të cilën ishin kryer ndërtime pa leje, nga pronari fillestar i tokës përmes shtetit për pronarin e ndërtesës pa leje, kundrejt pagesës së një çmimi shitjeje (seksionet 19-21) me para në dorë ose me anë të faturave të privatizimit (seksioni 17/1). Pronari i ligjshëm i tokës do të merrte kompensim të plotë në lidhje me parcelën e shpronësuar të tokës, në përputhje me ligjin për pronësinë të vitit 2004. Të ardhurat e nxjerra nga procesi i legalizimit do të transferoheshin në fondin e kompensimit financiar të parashikuar nga ligji për pronësinë të vitit 2004 (seksioni 32 i ndryshuar).

52. Statistikat në lidhje me procesin e legalizimit të parashikuar nga qeveria i bashkëlidhen këtij vendimi.

III. MATERIALI I KËSHILLIT EUROPIAN

53. Në vendimin e tij më të fundit të 6 qershorit 2012 në lidhje me mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës, në mbledhjen e tij të 1144-ët, Komiteti i Ministrave, ndër të tjera "theksoi përgatitjen nga autoritetet shqiptare të [një] projektstrategjie globale mbi të drejtat e pronësisë". Më tej, ai insistoi se autoritetet shqiptare duhet të bënin progres konkret, me qëllim "krijimin e një liste të vendimeve të formës së prerë, për të finalizuar hartën e vlerës së tokës, për të llogaritur koston e ekzekutimit të vendimeve që të mundësohej përcaktimi i burimeve të nevojshme, përdorimi i mekanizimit të ekzekutimit përfundimtar dhe ekzekutimi i vendimeve në fjalë."

LIGJI

I. BASHKIMI I ANKIMEVE

54. Për shkak se katër ankime ngrenë të njëjtën çështje, Gjykata vendos që ato të bashkohen sipas nenit 42 § 1 të rregullores së Gjykatës.

II. PRANUESHMËRIA E ANKIMEVE

55. Ankuesit pretendonin se kishte pasur një shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të konventës për shkak të moszbatimit të vendimeve administrative të formës së prerë që u jepnin atyre kompensim në vend të kthimit të pronave të tyre.

Neni 6 § 1 i konventës, në masën që është i zbatueshëm, parashikon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile... çdokush ka të drejtën e një procesi të drejtë...nga [një] gjykatë...”

Neni 13 i konventës parashikon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Neni 1 i protokollit nr. 1 të konventës parashikon si më poshtë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pronave të tij. Askush nuk privohet nga pronat e tij përveç në rastet e interesit publik dhe në bazë të kushteve të parashikuara me ligj dhe nga parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat pararendëse nuk cenojnë në ndonjë mënyrë të drejtën e një shteti për të zbatuar ato ligje që i çmon të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose kontributeve ose gjobave të tjera.”

A. Në lidhje me ankimin nr. 604/07: Manushaqe Puto

56. Më 6 tetor 2010, qeveria i kërkoi Gjykatës të shtynte shqyrtimin e këtij ankimi, duke pasur parasysh procedurat e rishikimit që kishin filluar *proprio motu* nga drejtori i agjencisë qendrore.

57. Ankuesit parashtruan se kompetenca e drejtorit të agjencisë qendrore për të rishikuar vendimet e Komisionit *proprio motu* ishte shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Ata i kërkuan Gjykatës të vazhdonte shqyrtimin e ankimit të tyre. Nga ana tjetër, ata u ankuan për shkelje të sigurisë së tyre juridike sipas nenit 6 § 1 të konventës.

58. Gjykata vëren se më 6 tetor 2008, në përputhje me dispozitat e ligjit për pronësinë të vitit 2004, të ndryshuar, drejtori i agjencisë qendrore vendosi *proprio motu* të rishikonte vendimin e Komisionit të 27 korrikut 1995 në favor të ankuesit. Më tej, ajo vëren se përkatësisht më 26 maj 2010 dhe 6 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese i shfuqizoi ato dispozita si të papajtueshme me Kushtetutën (shihni paragrafin 32 më lart). Duke marrë në konsideratë moskushtetushmërinë e këtyre dispozitave ndaj natyrës juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese (shihni paragrafin 33 më lart), Gjykata çmon se procedimet e rishikimit ishin bërë pa bazë ligjore si çështje e ligjit të brendshëm. Në këto rrethana, nuk i takon Gjykatës të vërë në dyshim karakterin përfundimtar të vendimit të Komisionit të 27 korrikut 1995, i cili nuk është rrëzuar asnjëherë nga autoritetet. Rrjedhimisht, si përfundim Gjykata rrëzon kundërshtimin e qeverisë.

B. Në lidhje me kërkesat e tjera

59. Qeveria argumentoi se ankuesit nuk kishin shfrytëzuar mjetet ligjore të paraqitura në periudhën 2005-2011.

60. Ankuesit argumentuan se mjetet ligjore nuk ishin efektive.

61. Gjykata çmon se çështja e ekzistencës së mjeteve ligjore efektive në lidhje me moszbatimin e vendimeve administrative të formës së prerë dhe në veçanti, të mjeteve ligjore të ofruara nga ligji për pronësinë i vitit 2004 (i paraqitur pas miratimit të vendimeve të kësaj Gjykate në çështjet Driza dhe Ramadhi dhe të tjerë, të cituara më lart) duhet të bashkohen në themel dhe të shqyrtohen në lidhje me ankimin e ankuesve sipas nenit 13 (shihni paragrafët 63-84 më poshtë). Në këtë kontekst, Gjykata çmon se meqë ankimi i ankuesve sipas nenit 6 § 1 të konventës është “i diskutueshëm”, për rrjedhojë neni 13 është i zbatueshëm (shihni, ndër të tjera, Eltari, i cituar më lart, § 80).

62. Gjykata çmon se ankimet e ankuesve nuk janë haptazi të pabazuara brenda kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të konventës. Duke mos qenë të papranueshme për arsye të tjera, rrjedhimisht ankimet duhet të shpallen të pranueshme.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

A. Parashtrimet e palëve

1. Ankuesit

63. Ankuesit parashtruan se nuk ishte marrë asnjë masë efektive për të garantuar zbatimin e vendimeve për dhënien e kompensimit. Procedura e agjencisë për dhënien e kompensimit financiar ishte tejte e zgjatur dhe e pasigurt. Përzgjedhja e përfituesve u bë me anë të hedhjes së shortit dhe kompensimi

nuk mund të kalonte vlerën e një parcele toke 200 metra katrorë. Për më tepër, hartat e vlerës së pronës nuk reflektonin vlerën e tregut. Llogaritja e tyre nuk ishte transparente dhe nuk parashikonte kamatëvonesën në rast të vonesës në pagesë.

64. Në lidhje me kompensimin me anë të obligacioneve shtetërore, siç u urdhërua nga Komisioni në ankimin nr. 46687/07 (Ahmatas dhe të tjerë), ankuesit parashtruan se qeveria, në fakt nuk kishte lëshuar asnjëherë obligacione shtetërore për qëllim kompensimi. Për më tepër, ndërsa kjo formë kompensimi u parashikua sipas ligjit për pronësinë të vitit 1993, ajo nuk u përfshi në ligjin aktual të pronësisë të vitit 2004.

65. Së fundi, ankuesit deklaruan se autoritetet nuk kishin marrë asnjë masë për dhënien e kompensimit në natyrë. Premtimet e autoriteteve për masa të ardhshme, duke përfshirë një projekt strategji mbi të drejtat e pronësisë, duhet të konsiderohen abuzive dhe më tej do të vononin procesin e kthimit dhe kompensimit.

2. Qeveria

66. Qeveria parashtrroi se që prej vitit 2007 kompensimi financiar po jepej çdo vit në të gjithë vendin. Deri në vitin 2009 dhënia e kompensimit financiar u kufizua në vlerën e një parcele 200 metra katrorë mbi bazën e hartave të vlerës së pronave. Ish-pronarët, të cilëve u ishin dhënë forma të tjera kompensimi nuk kishin të drejtë të merrnin kompensim financiar. Qëllimi i kësaj skeme ishte trajtimi në mënyrë të barabartë i ish-pronarëve, të cilët nuk kishin marrë asnjëherë kompensim, qoftë me anë të kthimit të pjesshëm të parcelave të tyre të tokës ose me anë të llojeve të tjera të kompensimit. Duke filluar nga viti 2010, skema e kompensimit financiar duhet të bazohej në një shkallë përqindjeje, informacionet e hollësishme për të cilën do të përcaktoheshin nga një grup pune që ishte krijuar për atë qëllim.

67. Në bazë të përvojës së mëparshme, qeveria deklaroi se në rast të një kërkesë të suksesshme për kompensim financiar, agjencia paguante shumën e kompensimit brenda 10 deri 15 ditëve nga shpallja e rezultateve. Në lidhje me pagesën e kamatëvonesës, qeveria argumentoi se ky interes ishte përfshirë në çmimet e hartave të vlerës së pronave që ishin përditësuar rregullisht. Çmimet reflektonin vlerën aktuale të tregut dhe ishin disa herë më të larta sesa çmimi i caktuar në kohën e njohjes të të drejtave të pronësisë. Në rast të një kërkesë të pasuksesshme për kompensim financiar, ankuesi duhet të riaplikonte vitin e ardhshëm me anë të paraqitjes së një kërkesë dhe deklarate standarde.

68. Në lidhje me mundësinë e dhënies së kompensimit në natyrë, qeveria parashtrroi se nuk ishte kryer asnjë kompensim në natyrë. Agjencia po punonte për përcaktimin dhe verifikimin e pronave shtetërore që do të shpërndaheshin si kompensim në natyrë. Për më tepër, ish-pronarët do të ftoheshin për t'u bërë aksionerë në ndërmarrjet shtetërore si mjet për marrjen e kompensimit. Të ardhurat e nxjerra nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore do të përdorreshin për dhëniet e kompensimit financiar ish-pronarëve. Qeveria ritheksoi synimin e saj për dhënien e plotë të kompensimit ndaj ish-pronarëve.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parime të përgjithshme

69. Gjykata rikujton se neni 13 shpreh drejtpërdrejt detyrimin e shtetit të parashikuar në nenin 1 të konventës, për të mbrojtur të drejtat e njeriut para së gjithash brenda sistemit të tyre ligjor. Rrjedhimisht, ajo kërkon që shtetet të ofrojnë një mjet ligjor të brendshëm për trajtimin e çështjes së një "ankimi të diskutueshëm" sipas konventës dhe për dhënien e kompensimit të përshtatshëm (shihni *Kudla kundër Polonisë* [GC], nr. 30210/96, § 152, GJEDNJ 2000-XI).

70. Objekti i detyrimeve të shteteve kontraktuese sipas nenit 13 ndryshon në varësi të natyrës së ankimit të ankuesit; "efektiviteti" i një "mjeti ligjor" brenda kuptimit të nenit 13 nuk varet nga siguria e një përfundimi të favorshëm për ankuesin. Njëkohësisht, mjeti ligjor i kërkuar nga neni 13 duhet të jetë "efektiv" në praktikë si dhe në ligj, në kuptimin ose të parandalimit të shkeljes së pretenduar ose vazhdimi të saj, ose të ofrimit të kompensimit të mjaftueshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur. Edhe nëse një mjet i vetëm ligjor nuk përmbush tërësisht në vetvete kërkesat e nenit 13, tërësia e mjeteve ligjore të parashikuara sipas ligjit të brendshëm mund ta realizojë këtë (shihni *Kudla* të cituar më lart, §§ 157-158, dhe *Wasserman kundër Ruisë* (nr. 2), nr. 21071/05, § 45, 10 prill 2008).

71. Në çështjet në lidhje me moszbatimin e vendimeve të formës së prerë, çdo mjet i brendshëm ligjor për parandalimin e një shkeljeje duke garantuar zbatimin në kohë është, në parim, i një vlere më të madhe. Megjithatë, kur një vendim i formës së prerë është shpallur në favor të një individi kundër shtetit, në parim individi nuk duhet të detyrohet të paraqesë procedura përmbartimore (shihni, *mutatis mutandis*, *Metaxas kundër Greqisë*, nr. 8415/02, § 19, 27 maj 2004).

2. Zbatimi i parimeve për çështjen në fjalë

72. Gjykata vëren se ankimet në fjalë lidhen me moszbatimin e vendimeve të Komisionit që i

jepnin ankuesve kompensim në vend të kthimit të pronave. Gjykata shqyrtoi fillimisht çështjen e efektivitetit të zbatimit të këtyre vendimeve administrative në çështjen *Ramadhi dhe të tjerë* (të cituar më lart, §§ 45-53), ku konstatoi shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1 të konventës. Më tej, Gjykata konstatoi si më poshtë:

“50. Gjykata vëren se asnjë prej ligjeve për pronësinë ose ndonjë dispozitë e brendshme përkatëse nuk ka rregulluar zbatimin e vendimeve të Komisionit. Në veçanti, ligjet për pronësinë nuk parashikojnë afat statutor për ankim kundër këtyre vendimeve para gjykatave të brendshme ose për ndonjë mjet ligjor specifik për zbatimin e tyre. Më tej, Gjykata vëren se ligjet për pronësinë ia linin përcaktimin e formës dhe mënyrës përkatëse të kompensimit, Këshillit të Ministrave, i cili duhet të përcaktonte rregullat dhe metodat e hollësishme për këtë kompensim. Deri tani nuk janë marrë masa të tilla (...) dhe qeveria nuk dha asnjë shpjegim në lidhje me këtë.

51. Se autoritetet janë të angazhuara, siç pohoi qeveria, ndaj kthimit të pronave dhe pagesa e kompensimit përkatës nuk çoi në zbatimin e vendimeve në favor të ankuesit, tashmë të pazbatuara për përkatësisht 12 dhe 11 vjet. Për më tepër, qeveria nuk ka paraqitur prova se masat përkatëse do të ndërmerren brenda një kohe të shkurtër.

52. Faktorët e mësipërm janë të mjaftueshëm për t'i dhënë mundësinë Gjykatës të nxjerrë përfundimin se, duke mos mundur të marrë masat e nevojshme për parashikimin e mjeteve për zbatimin e vendimeve të Komisionit, ankuesit ishin privuar nga e drejta e tyre për mjet ligjor efektiv, duke u dhënë atyre mundësinë të garantojnë zbatimin e të drejtës së tyre civile për kompensim (...)”

73. Gjykata vëren se që prej miratimit të vendimit në *Ramadhi dhe të tjerë*, qeveria ka miratuar një numër të konsiderueshëm aktesh ligjore në lidhje me dhënien e kompensimit financiar, miratimin e hartave të vlerës së pronave, krijimin e IkFC-së dhe miratimin e planit të veprimtari.

74. Gjykata vëren se Komisioni vendosi që ankuesit në fjalë të kompensohen në një prej formave të parashikuara me ligj (shihni, gjithashtu, paragrafin 26 më lart). Gjykata do të shqyrtojë tashmë, duke marrë parasysh parashtrimet e palëve, nëse masat zbatuese janë marrë për realizimin e alokimeve në një prej formave të kompensimit të parashikuara me ligj dhe nëse masat mund të konsiderohen të çojnë në një mjet efektiv ligjor brenda kuptimit të nenit 13 të konventës.

(a) Kompensimi në natyrë

75. Gjykata vëren parashtrimin e qeverisë se deri tani, kjo formë kompensimi nuk ishte dhënë asnjëherë (shihni paragrafin 68 më lart). Për më tepër, ajo rritet përfundimet e saj në çështjen *Çaush Driza* (të cituar më lart §§ 78-83) në kuptimin që kjo formë kompensimi nuk është mjet ligjor efektiv.

(b) Kompensimi me anë të aksioneve shtetërore dhe të ardhurave nga procesi i privatizimit

76. Gjykata vëren se qeveria nuk ka dhënë prova për të treguar se ky lloj kompensimi tashmë ishte dhënë në raste të mëparshme.

(c) Obligacionet shtetërore

77. Gjykata vëren se ligji për pronësinë i vitit 2004, i ndryshuar, nuk parashikon kompensimin me anë të obligacioneve shtetërore dhe qeveria nuk shpjegoi sesi ishte parashikuar zbatim i vendimeve të Komisionit që i jepnin ankuesve obligacione shtetërore si kompensim.

(d) Kompensimi financiar

78. Gjykata vëren se pjesa më e madhe e parashtrimeve të palëve fokusohej në dhënien e kompensimit financiar nga autoritetet për ish-pronarët gjatë periudhës 2005-2009, në lidhje me të cilën Gjykata bën vërejtjet e mëposhtme.

79. Vendimet e autoriteteve (shihni paragrafët 35-37 më lart) fillimisht njihnin të drejtën e një ankuesi për kompensim financiar vetëm nëse Komisioni kishte dhënë kompensim në lidhje me të gjithë pronën. Rrjedhimisht, siç u parashtrua nga qeveria dhe siç u evidentua nga lista e ankuesve që kishin aplikuar për kompensim financiar në periudhën 2005-2008 (shihni shtojcën bashkëlidhur), nëse një ankues merrte kthim të pjesshëm të pronës ose forma të tjera kompensimi, ai nuk do të kishte të drejtë të merrte kompensim financiar. Ky është qëndrimi i mbajtur në dy ankime (nr. 43628/07 (*Dani*) dhe 34770/09 (*Muka*). Ankuesit në këto çështje nuk do të kishin të drejtë të merrnin kompensim financiar për shkak se u ishte dhënë më parë një parcelë toke.

80. Së dyti, vendimet e autoriteteve parashikojnë një shumë maksimale kompensimi financiar të barabartë me vlerën prej 200 metra katrorë. Është e vërtetë se legjislacioni nuk kufizon shumën përfundimtare të kompensimit që duhet të jetë në vlerën e tregut, se qeveria ishte angazhuar vazhdimisht për dhënien e kompensimit të plotë (shihni paragrafët 44 dhe 68 më lart) dhe se të gjithë ankuesve në fjalë u ishte dhënë kompensimi në lidhje me parcelat e tokës mbi 200 metra katrorë. Megjithatë, kompensimi

financiar është forma e vetme e kompensimit e dhënë aktualisht. Rrjedhimisht, nëse ankuesit do të kishin aplikuar dhe do të ishin kompensuar në lidhje me 200 metra katrorë, e drejta e tyre për zbatimin e pjesës tjetër të vendimeve të tyre do të kishte qenë e pasigurt. Në fakt, megjithëse ankuesit në ankimin nr. 46684/07 (*Ahmatas dhe të tjerë*) morën kompensim financiar, deri tani pjesa tjetër e vendimit në favor të tyre mbetet e pazbatuar. Për më tepër, Gjykata nuk është e bindur se dhënia e kompensimit financiar e barabartë me vlerën prej 200 metra katrorë, pavarësisht parcelës së tokës të njohur për qëllim kompensimi, do të garantonte barazi efektive të trajtimit të ankuesve, siç argumentohet nga qeveria. Personat, situatat e të cilëve janë mjaft të ndryshme, duhet të trajtohen ndryshe (shihni *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, § 44, GJEDNJ 2000-IV).

81. Së treti, ndërsa një ankuesi mund t'i kërkohej të marrë hapa të caktuar proceduralë për të aplikuar për kompensim financiar, Gjykata nuk mund të pranojë që një ankues i pasuksesshëm në një vit të caktuar pararendës duhet të kërkohej të riparaqesë ankim tjetër në vitin(et) pasardhës(e). Barra për të respektuar një vendim të formës së prerë kundër shtetit qëndron kryesisht tek autoritetet shtetërore, të cilat duhet të përdorin të gjitha mjetet e disponueshme në sistemin e brendshëm ligjor, me qëllim përshpejtimin e zbatimit, duke parandaluar kështu shkeljet e konventës (*Burdov kundër Rusisë* (nr. 2), nr. 33509/04, § 98, GJEDNJ 2009). I takon shtetit të paditur të organizojë sistemin e tij ligjor, në mënyrë të tillë që të jetë i aftë të menaxhojë infrastrukturën teknike dhe logjistike për të garantuar që skema e kompensimit të jetë në çdo kohë “efektive dhe e shpejtë” (shihni *Broniowski kundër Polonisë* [GC], nr. 31443/96, § 194, GJEDNJ 2004-V).

82. Së katërti, nuk do të ishte efektive nëse dhënia e kompensimit financiar nuk do të merrte parasysh dëmin jomonetar të shkaktuar si rezultat i moszbatimit tejet të zgjatur (shihni *Scordino kundër Italisë* (nr. 1) [GC], nr. 36813/97, §§ 203-4, GJEDNJ 2006-V; *Burdov* (nr. 2), të cituar më lart, §§ 100 dhe 111). Në çështjen në fjalë, Gjykata nuk është e aftë të kuptojë sesi vendimet e autoriteteve justifikojnë dhe llogarisin dëmin jomonetar.

83. Si rezultat, Gjykata nxjerr përfundimin se kjo formë kompensimi nuk është efektive.

(e) Konkluzion

84. Duke marrë në konsideratë konkluzionet e mësipërme, Gjykata nxjerr përfundimin se nuk ka pasur mjet të brendshëm ligjor efektiv që të mundësonte kompensim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për shkak të moszbatimit të zgjatur të vendimeve të Komisionit që jepnin kompensim. Rrjedhimisht, ka një shkelje të nenit 13 të konventës. Për pasojë, Gjykata rrëzon kundërshtimin e qeverisë se ankuesit nuk mundën të shteronin mjetet e brendshme ligjore efektive.

IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS DHE NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1

A. Parashtrimet e palëve

1. Ankuesit

85. Ankuesit u ankuan se vendimet administrative të formës së prerë në favor të tyre mbetën të pazbatuara. Megjithëse disa ankues morën kompensim të pjesshëm financiar, pjesa tjetër e vendimeve të Komisionit vazhdon të mbetet e pazbatuar. Argumentet e qeverisë në lidhje me mungesën e fondeve tashmë ishin rrëzuar nga Gjykata në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (nr. 7352/03, § 102, 22 gusht 2006).

86. Ankuesit argumentuan se, në bazë të vendimeve të formës së prerë të Komisionit, ata kishin një “pretendim” dhe rrjedhimisht, “pronat” brenda kuptimit të nenit 1 të protokollit nr. 1. Moszbatimi i këtyre vendimeve të formës së prerë për një periudhë të gjatë kohe, pa ndonjë justifikim, kishte çuar në shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të konventës.

2. Qeveria

87. Qeveria argumentoi se pagesa e menjëhershme e të gjitha pretendimeve të kompensimit do të paralizonte mekanizmin e shtetit. Parimi i respektimit të detyrimeve nga shteti, siç referohet në jurisprudencën e Gjykatës, lidhet vetëm me raste sporadike dhe jo të përhapura të moszbatimit. Zbatimi i vendimeve të formës së prerë nuk shtrihej në situata të vazhduara që ishin krijuar përpara hyrjes në fuqi të konventës, aq më tepër kur këto probleme ishin trashëguar nga një regjim totalitar që kishte shuar të gjitha të drejtat e pronësisë.

88. Qeveria ia atribuonte moszbatimin e vendimeve administrative të formës së prerë: a) mungesës së fondeve; b) ndryshimeve të shpeshta të legjislacionit; b) miratimit fillestar të hartave të vlerës së pronës jo më vonë se viti 2005; c) mungesës së një sistemi të saktë adresash; d) vështirësive në identifikimin e trashëgimtarëve të ish-pronarëve që çonin në vonesa; dhe e) mungesës të të dhënave në lidhje me fazën e

procedimeve të rishikimit gjyqësor në lidhje me vendimet e Komisionit.

89. Më tej, ata parashtruan se ishin duke marrë masa të menjëhershme për të krijuar IkCF-në dhe për të përfshirë ish-pronarët në privatizimin e ndërmarrjeve dhe objekteve shtetërore. Duke marrë parasysh barrën e kompensimit me të cilën ishte ngarkuar shteti, ata parashtruan se kishin bërë përpjekjet maksimale për të garantuar zbatimin e vendimeve të formës së prerë dhe të drejtën e ish-pronarëve për kompensim.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parime të përgjithshme

(a) Në lidhje me nenin 6 § 1 të konventës

90. Gjykata i referohet parimeve të përgjithshme të paraqitura, ndër të tjera, në çështjen *Burdov* (nr. 2), të cituar më lart, §§ 65-70 (pa referenca).

“65. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës e mbrojtur nga neni 6 do të ishte jo reale, nëse një sistem i brendshëm ligjor i një shteti kontraktues do të lejonte që një vendim gjyqësor detyrues, i formës së prerë të mbetej jofunksional, në dëm të një pale. Rrjedhimisht, ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e “gjykimit”, për qëllime të nenit 6 (...).

66. Një vonesë e gjatë në mënyrë të paarsyeshme për zbatimin e një vendimi detyrues mund të shkaktojë shkeljen e konventës (...). Arsyeshmëria e kësaj vonese duhet të përcaktohet duke marrë parasysh veçanërisht kompleksitetin e procedurave përmbartimore, sjelljen e vetë ankuesit dhe të autoriteteve kompetente, si dhe shumën dhe natyrën e vendimit të gjykatës (...).

67. Ndërsa Gjykata ka marrë në konsideratë afatet ligjore të brendshme të përcaktuara me ligj, të caktuara për procedurat përmbartimore, mosrespektimi i tyre, nuk çon automatikisht në shkelje të konventës. Një vonesë mund të justifikohet në rrethana të veçanta por në asnjë rast, nuk mund të jetë e tillë që të dëmtojë thelbin e të drejtës së mbrojtur sipas nenit 6 § 1 (...). Kështu, Gjykata çmoi, për shembull, në një çështje të kohëve të fundit në lidhje me Rusinë, se një vonesë e përgjithshme prej nëntë muajsh e shkaktoi nga autoritetet për zbatimin e një vendimi nuk ishte *prima facie* e paarsyeshme sipas konventës (...). Megjithatë, ky supozim nuk shmang nevojën për vlerësim, duke marrë në konsideratë kriteret e lartpërmendura (...) dhe rrethana të tjera përkatëse (...).

68. Një person që ka marrë një vendim kundër shtetit nuk mund të pritët të paraqesë procedura të ndara përmbartimore (...) Në këto raste, autoriteti i shtetit të paditur duhet të njoftohet sipas rregullave për vendimin dhe kështu është i mirëpozicionuar për të ndërmarrë të gjitha iniciativat e nevojshme për ta respektuar atë ose për t’ia transmetuar një autoriteti tjetër kompetente shtetëror përgjegjës për ekzekutimin. Kjo lidhet veçanërisht me një situatë ku, duke marrë parasysh kompleksitetet dhe mbivendosjen e mundshme të procedurave të ekzekutimit dhe zbatimit, një ankues mund të ketë dyshime të arsyeshme se cili autoritet është përgjegjës për ekzekutimin ose zbatimin e një vendimi (...).

69. Një palë e suksesshme ndërgjyqëse mund të kërkojë të ndërmarrë hapa të caktuar proceduralë, me qëllim shlyerjen e një detyrimi me vendim gjykate, qoftë gjatë një ekzekutimi vullnetar të një vendimi nga shteti ose gjatë zbatimit të tij me mjete të detyrueshme (...) Rrjedhimisht, nuk është e paarsyeshme që autoritetet t’i kërkojnë ankuesit të përgatisë dokumente shtesë, si për shembull informacione të hollësishme bankare, për të mundësuar ose shpejtuar ekzekutimin e një vendimi (...). Gjithsesi, kërkesa e bashkëpunimit të kreditorëve nuk duhet të tejkalojë çka është rreptësisht e nevojshme dhe në çdo rast, nuk lehtëson autoritetet nga detyrimi i tyre sipas konventës për të marrë masa në kohë me mocionin e tyre, mbi bazën e informacionit që u është vënë në dispozicion, me synim respektimin e vendimit kundër shtetit (...) Kështu, Gjykata çmon se barra për të garantuar pajtueshmëri me një vendim kundër shtetit qëndron kryesisht tek autoritetet shtetërore, duke filluar nga data në të cilën vendimi bëhet i detyrueshëm dhe i zbatueshëm.

70. Kompleksiteti i procedurës së brendshme përmbartimore ose të sistemit buxhetor të shtetit nuk mund të lehtësojë shtetin nga detyrimi i tij sipas konventës, për t’i garantuar çdokujt të drejtën për zbatimin e një vendimi gjyqësor të zbatueshëm dhe detyrues, brenda një afati të arsyeshëm. Nuk i takon një autoriteti shtetëror që të citojë mungesën e fondeve ose burimeve të tjera (si për shembull strehimin) si justifikim për mosrespektimin e një detyrimi sipas një vendimi gjykate (...) I takon shteteve kontraktuese të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të tillë që autoritetet kompetente të mund të përmbushin detyrimin e tyre në këtë drejtim (...). ”

91. Të njëjtat parime u përshkruan edhe në çështjen *Yuriy Nikolayevich Ivanov kundër Ukrainës*, nr. 40450/04, §§ 51-54 të datës 15 tetor 2009.

(b) Në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të konventës

92. Gjykata i referohet parimeve të përgjithshme të caktuara, ndër të tjera, në çështjen *Maria Atanasu dhe të tjerë kundër Rumanisë*, nr. 30767/05 dhe 33800/06, §§ 134-37 dhe 163-68 të datës 12 tetor

2010 (pa referenca).

“134. Gjykata rithekson se një ankues mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 vetëm në masën që vendimet e kundërshtuara lidhen me “pronat” e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite. “Pronat” mund të jenë ose “prona ekzistuese” ose pasuri, duke përfshirë pretendimet në lidhje me të cilat ankuesi mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “pritshmëri të ligjshme” të përfuturit të gëzimit efektiv të një të drejte pronësie (...).

135. Gjykata vëren më tej se neni 1 i protokollit nr. 1 nuk mund të interpretohet sikur vendos ndonjë detyrim të përgjithshëm ndaj palëve kontraktuese për të kthyer pronën që u ishte transferuar atyre përpara se të ratifikonin konventën (...).

136. Nga ana tjetër, nëse një shtet kontraktues që ka ratifikuar konventën, duke përfshirë protokollin nr. 1, miraton legjislacion që parashikon kthimin e plotë ose të pjesshëm të pronës së konfiskuar sipas një regjimi të mëparshëm, ky legjislacion mund të konsiderohet se sjell një të drejtë të re pronësie të mbrojtur nga neni 1 i protokollit nr. 1 për personat që përmbushin kërkesat e pranueshmërisë (...).

137. Kur interesi pronësor është në natyrën e një ankimi, ai mund të konsiderohet si “pasuri” vetëm nëse ka bazë të mjaftueshme në ligjin kombëtar, për shembull nëse ka një praktikë të përfunduar të gjykatave të brendshme që e konfirmon atë (...).

.....

163. Privimi nga pronësia ose nga një e drejtë tjetër in rem është në parim një akt i menjëhershëm dhe nuk sjell një situatë të vazhdueshme të “privimit nga një e drejtë” (...).

164. Ashtu si neni 1 i protokollit nr. 1 nuk garanton të drejtën për marrjen e pronës, ai nuk vendos kufizime ndaj lirisë së shteteve kontraktuese për të përcaktuar fushën e veprimit të kthimit të pronave dhe për të zgjedhur kushtet sipas të cilave ata bien dakord për rikthimin e të drejtave të pronësisë ish-pronarëve (...).

165. Nga ana tjetër, neni 1 i protokollit nr. 1 kërkon që çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në gëzimin paqësor të pronave duhet të jetë i ligjshëm (...) Parimi i ligjshmërisë gjithashtu presupozon se dispozitat e zbatueshme të ligjit të brendshëm duhet të jenë mjaftueshmërisht të aksesueshme, të sakta dhe të parashikueshme në zbatimin e tyre (...).

166. Për më tepër, çdo ndërhyrje në gëzimin e një të drejte ose lirie të njohur nga konventa, duhet të ndjekë një qëllim të ligjshëm. Me të njëjtin tregues, në rastet që përfshijnë një detyrim pozitiv, duhet të ketë një justifikim të ligjshëm për mosveprimin e shtetit. Parimi i “balancës së drejtë” i mishëruar në nenin 1 të protokollit nr. 1 presupozon në vetvete ekzistencën e një interesi të përgjithshëm të komunitetit. Për shkak të njohurisë së tyre të drejtpërdrejtë mbi shoqërinë dhe nevojat e tyre, autoritetet kombëtare në parim janë më të mirëpozicionuara sesa gjykatësi ndërkombëtar për të vlerësuar se çfarë është “në interesin publik”. Rrjedhimisht, sipas sistemit të mbrojtjes të krijuar nga konventa, i takon autoriteteve kombëtare të kryejnë vlerësimin fillestar në lidhje me ekzistencën e një problemi të interesit publik që kërkon zbatimin e masave në sferën e ushtrimit të së drejtës ndaj pronës, duke përfshirë privimin dhe kthimin e pronave. Në këtë pikë, si në fusha të tjera në të cilat shtrihen garancitë e konventës, për pasojë autoritetet kombëtare gëzojnë një shkallë të caktuar vlerësimi.

Për më tepër, nocioni i “interesit publik” është detyrimisht i zgjeruar. Në veçanti, vendimi për të miratuar ligje që shpronësojnë pronën ose japin kompensim të financuar publikisht për pronat e shpronësuara do të përfshijnë zakonisht shqyrtimin e çështjeve politike, ekonomike dhe sociale. Duke e konsideruar të natyrshme se shkalla e vlerësimit e disponueshme në legjislaturë për zbatimin e politikave sociale dhe ekonomike, duhet të jetë e gjerë, Gjykata ka shpallur se ajo do të respektojë vendimin e legjislaturës se çfarë është “në interesin publik”, nëse ai vendim nuk është haptazi i pabazuar (...).

167. Ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronave dhe mosveprimi duhet të vendosin një balancë të drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes të të drejtave themelore të individëve. Në veçanti, duhet të ekzistojë një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet nga masat e zbatuara nga shteti, duke përfshirë masat që privojnë një person nga pronat e tij ose të saj. Megjithatë, në çdo rast që përfshin shkeljen e pretenduar të këtij neni, Gjykata duhet të konstatojë nëse për shkak të veprimit ose mosveprimit të shtetit, personi përkatës duhet të mbante një barrë të tepërt dhe joproporcionale (...).

168. Në vlerësimin e respektimit të nenit 1 të protokollit nr. 1, Gjykata duhet të kryejë një vlerësim të përgjithshëm të interesave të ndryshme në fjalë, duke pasur parasysh se konventa synohet të mbrojë të drejtat që janë “praktike dhe efektive”. Ajo duhet të mos mbështet tek gjasat dhe të analizojë situatën reale që i nënshtrohet ankimit Ky vlerësim mund të përfshijë jo vetëm kushtet përkatëse të kompensimit-nëse

situata është e ngjashme me marrjen e pronës-por edhe sjelljen e palëve, duke përfshirë mjetet e përdorura nga shteti dhe zbatimin e tyre. Në këtë kontekst, duhet të theksohet se pasiguria-qoftë legjislative, administrative ose kur lind nga praktikat e zbatuara nga autoritetet-është një faktor që duhet të merret në konsideratë për vlerësimin e sjelljes së Shtetit. Në të vërtetë, kur një çështje në interesin e përgjithshëm rrezikohet, i takon autoriteteve publike të veprojnë në kohën e përshtatshme, në një mënyrë të duhur dhe të pranueshme (...)

2. Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

93. Gjykata tashmë ka konstatuar shkelje të ngjashme të nenit 6 § 1 të konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të konventës në çështje të tjera në lidhje me vonesat në zbatimin e vendimeve administrative dhe të formës së prerë për pronat në lidhje me shtetin e paditur (shihni, midis autoriteteve të tjera, *Ramadhi dhe të tjerë*, e cituar më lart, §§ 45-54 dhe 75-84; *Hamzaraj* (nr. 1) e cituar më lart, §§ 24-27 dhe 38-43; dhe *Nuri kundër Shqipërisë*, nr. 12306/04, §§ 26-29 dhe 35-40, 3 shkurt 2009. Ajo do të shqyrtojë nëse qeveria ka bërë parashtrime përkatëse dhe të reja.

94. Qeveria shpjegoi se zbatimi i vendimeve të formës së prerë ishte i mundur në një numër të vogël çështjesh por jo në një numër të madh ankimesh. Megjithatë, çdo ankues ka të drejtën e zbatimit të një vendimi të formës së prerë në favor të tij (shihni *Hornsby kundër Greqisë*, 19 mars 1997, § 40, *Raportet e gjykimeve dhe vendimeve* 1997-II). Çështja nëse moszbatimi i vendimeve të formës së prerë ngre një çështje sistematike do të shqyrtohet sipas nenit 46 të konventës më poshtë (shihni paragrafët 99-121 më poshtë).

95. Qeveria vuri në dyshim zbatimin e konventës për vendimet e formës së prerë të miratuara përpara hyrjes së saj në fuqi në lidhje me shtetin e paditur. Gjykata vëren se moszbatimi i vendimeve të formës së prerë në fjalë vazhdonte edhe pas hyrjes në fuqi të konventës më 2 tetor 1996. Në fakt, kjo vazhdon ende. Rrjedhimisht, konventa është e zbatueshme.

96. Mungesa e fondeve ose burimeve të tjera si shkak për mosrespektimin e një detyrimi me vendim gjykate, nuk mund të lehtësojë shtetin nga detyrimi i tij sipas konventës për të garantuar pajtueshmëri me një vendim të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm (shihni, për shembull, *Burdov*, cituar më lart, § 35; *Beshiri dhe të tjerë*, e cituar më lart, § 102; dhe *Kukalo kundër Rusisë*, nr. 63995/00, § 49, 3 nëntor 2005). Faktorët e tjerë të shtuar nga qeveria në paragrafin 88 më lart thjesht theksojnë veprimin e vonuar të autoriteteve dhe pamundësinë për të vepruar, me qëllim trajtimin e zbatimit të vendimeve të komisionit.

97. Në rrethanat e kësaj çështjeje, vendimet e zbatueshme dhe të formës së prerë të Komisionit në favor të ankuesve mbetën të pazbatuara për periudha nga 15 deri 17 vjet. Pas shqyrtimit të materialeve të paraqitura pranë saj, Gjykata nuk sheh arsye të shmanget nga përfundimet e saj në çështjet e mëparshme (shihni paragrafi 92 më lart). Rrjedhimisht, ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të konventës në secilin ankim.

V. ZBATIMI I NENIT 46 TË KONVENTËS

98. Neni 46 i konventës parashikon:

“1. Palët e larta kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.

A. Parashtrimet e palëve

1. Ankuesit

99. Ankuesit në ankimet nr. 604/07 (*Manushaqe Puto*), 43628/07 (*Dani*) dhe 46684/07 (*Ahmatas dhe të tjerë*) nuk kundërshtuan ankimin e procedurës së gjykimit-pilot, duke pasur parasysh premtimet e autoriteteve për të hartuar plane veprimi jorealiste dhe joefektive ose strategji (ndër) sektoriale mbi kthimin dhe kompensimin e pronave. Megjithatë, ata vunë në dyshim dobishmërinë e tyre, duke marrë parasysh faktin se masat e përgjithshme tashmë i ishin paraqitur qeverisë sipas nenit 46 në vendimet *Driza*, të cituar më lart; *Ramadhi dhe të tjerë*, të cituar më lart; *Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë*, nr. 35720/04 dhe 42832/06, § 87, 29 shtator 2009; dhe *Delvina kundër Shqipërisë*, nr. 49106/06, §§ 85-88, 8 mars 2011. Nëse Gjykata do të zbatonte procedurën e gjykimit-pilot, atyre ankuesve do t'u kërkohej që zbatimi i nenit 41 të konventës në çështjet e mësipërme nuk duhet të ishte rezervuar. Për më tepër, ata i kërkuan Gjykatës të vazhdonte shqyrtimin e të gjitha çështjeve të ngjashme të regjistruara që i ishin komunikuar qeverisë.

100. Ankuesi në ankimin nr. 34770/09 (*Muka*) parashitroi se procesi i kompensimit ishte një

dështim i plotë dhe se mund të karakterizohet si një problem strukturor/sistemik. Ky dështim e kishte origjinën në kuadrin legjislativ, si dhe në paaftësinë e autoriteteve për të krijuar një mekanizëm efektiv për dhënien e kompensimit.

2. Qeveria

101. Qeveria parashtrroi paraprakisht se problemet e identifikuar në rastet e mësipërme ishin të ngjashme me ato të identifikuar në vendimin Driza të cituar më lart. Problemet strukturore në lidhje me moszbatimin e vendimeve të formës së prerë në përgjithësi u trajtuan në një dokument pune të hartuar nga qeveria dhe Komiteti i Ministrave në kuadër të mbikëqyrjes dhe ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës. Qeveria çmoi se situata në Shqipëri i ngjante asaj të përshkruar në çështjen *Maria Atanasiu dhe të tjerë*, të cituar më lart. Rrjedhimisht, çështja duhet të jetë e përshtatshme për zbatimin e procedurës së gjykimit-pilot. Më tej, ata parashtruan se rezervonin të drejtën për të kërkuar zyrtarisht zbatimin e procedurës së gjykimit-pilot në një fazë të mëvonshme.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parimet e përgjithshme

102. Gjykata rikujton se neni 46 i konventës që interpretohet duke marrë parasysh nenin 1, vendos ndaj shtetit të paditur një detyrim ligjor për zbatimin sipas mbikëqyrjes së Komitetit të Ministrave, të masave të nevojshme individuale dhe/ose të përgjithshme për të garantuar të drejtën e ankuesit që Gjykata konstatoi të jetë shkelur. Këto masa duhet të merren edhe në lidhje me persona të tjerë në pozicionin e ankuesit, kryesisht duke zgjidhur problemet që kanë çuar në përfundimet e Gjykatës. Ky detyrim ishte theksuar vazhdimisht nga Komiteti i Ministrave në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës për çështjet në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve në Itali, si dhe në çështjet në lidhje me veprimin e forcave të sigurisë në Turqi (shihni *Burdov* (nr. 2), cituar më lart § 125).

103. Në bazë të monitorimit nga Komiteti i Ministrave, shteti i paditur mbetet i lirë të zgjedhë mjetet me të cilat do të përmbushë detyrimin e tij ligjor sipas nenit 46 të konventës, me kusht që këto mjete të jenë të pajtueshme me përfundimet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës (shihni *Maria Atanasiu dhe të tjerë*, i cituar më lart, § 211)

104. Objekti i përcaktimit të çështjes nga gjykata për “procedurën e gjykimit-pilot” është lehtësimi i zgjidhjes më të shpejtë dhe më efektive të një situatë jofunksionale që cenon mbrojtjen e të drejtës në fjalë të konventës në rendin juridik kombëtar. Qëllimi i procedurës së gjykimit-pilot është nxitja e shtetit të paditur për të zgjidhur një numër të madh çështjesh individuale që lindin nga i njëjti problem strukturor në nivel të brendshëm, duke zbatuar kështu parimin e subsidiaritetit që fuqizon sistemin e konventës (shihni *Maria Atanasiu dhe të tjerë*, të cituar më lart, § 212)

105. Një prej faktorëve përkatës të shqyrtuar nga Gjykata në hartimin dhe zbatimin e procedurës së gjykimit-pilot ka qenë rreziku në rritje ndaj sistemit të konventës që shkaktohet nga një numër i madh çështjesh të përsëritura që rrjedhin, ndër të tjera, nga i njëjti problem strukturor ose sistemik. Në fakt, detyra e Gjykatës, siç përcaktohet nga neni 19, pra “të garantojë respektimin e angazhimeve të ndërrmarra nga palët e larta kontraktuese të konventës dhe protokollet e saj” nuk është arritur domozdoshmërisht më mirë duke përsëritur të njëjtat përfundime në një numër të madh çështjesh (shihni *Burdov* (nr. 2), të cituar më lart, § 127).

106. Ndërsa veprimi i shtetit të paditur duhet të synojë kryesisht zgjidhjen e kësaj situatë jofunksionale dhe paraqitjen, sipas rastit, të mjeteve ligjore të brendshme efektive në lidhje me çështjet në fjalë, ai mund të përfshijë edhe zgjidhje të posaçme si zgjidhje miqësore me ankuesit ose oferta të njëanshme rregulluese në përputhje me kërkesat e konventës. Gjykata mund të vendosë të shtyjë shqyrtimin e të gjitha çështjeve të ngjashme, duke i dhënë kështu shtetit të paditur mundësi për t’i zgjidhur në këto mënyra të ndryshme. 128. Megjithatë, nëse shteti i paditur nuk arrin të marrë këto masa pas një gjykimi pilot dhe vazhdon të shkelë konventën, Gjykata nuk do të ketë zgjidhje tjetër veç se të rifillojë shqyrtimin e të gjitha ankimeve të ngjashme të pazgjidhura të paraqitura pranë saj dhe t’ia nënshtrojë gjykimit, në mënyrë që të garantojë respektimin efektiv të konventës (shihni *Burdov* (nr. 2), të cituar më lart, § 128).

1. Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

(a) Ekzistenca e një praktike të papajtueshme me konventën

107. Gjykata rikujton fillimisht, siç deklarohet në paragrafin 90 të vendimit *Ramadhi dhe të tjerë*, se shkeljet e konstatuara në vendimin në fjalë “e kishin origjinën nga një problem i përhapur që prekte një numër të madh njerëzish”, pra të metat rregullatore dhe/ose sjellja administrative e autoriteteve për zbatimin e vendimeve të formës së prerë të Komisionit që u japin kompensim ish-pronarëve sipas ligjeve për pronësinë.

108. Gjykata vëren me shqetësim se ajo ka konstatuar shkelje në çështjen në fjalë, pavarësisht nga

masat e përgjithshme të përcaktuara në vendimet e saj të mëparshme në vitin 2007, 2009 dhe 2011 në çështjet *Driza*, të cituar më lart; *Ramadhi dhe të tjerë*, të cituar më lart; *Vrioni dhe të tjerë*, të cituar më lart; dhe *Delvina*, të cituar më lart). Duke marrë parasysh numrin e çështjeve të ngjashme të pazgjidhura para Gjykatës dhe statistikat e dhëna nga qeveria (shihni shtojcën bashkëlidhur), Gjykata është seriozisht e shqetësuar se numri i ankimeve të bazuara të regjistruara mund të rritej dhe rrjedhimisht, përfaqëson një rrezik serioz ndaj efektivitetit të ardhshëm të mekanizmit të konventës (shihni, ndër të tjera, *Yuriy Nikolayevich Ivanov*, të cituar më lart, § 86).

(b) Zbatimi i procedurës së gjykimit-pilot

109. Duke marrë parasysh numrin e madh të problemeve në lidhje me mekanizmin e kompensimit që vazhdojnë edhe pas miratimit të vendimeve në çështjet *Driza*, *Ramadhi dhe të tjerë*, *Vrioni dhe të tjerë*, dhe *Delvina*, të cituara më lart, si dhe nevojën urgjente për dhënien e kompensimit të shpejtë dhe të përshtatshëm ndaj ankuesve në nivel kombëtar, Gjykata çmon thelbësor zbatimin e procedurës së gjykimit pilot në këtë çështje. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se nuk ka realizuar një gjykim pilot në asnjë prej rasteve të mësipërme.

(c) Masa të përgjithshme

110. Gjykata çmon se shteti i paditur duhet të marrë masa të përgjithshme prioritare, me qëllim sigurimin në mënyrë efektive të të drejtës për kompensim ndërsa vendos balancë të drejtë midis interesave të ndryshme në fjalë (shihni, për shembull *Burdov* (nr. 2), të cituar më lart, § 125). Në bazë të monitorimit nga Komiteti i Ministrave, shteti i paditur mbetet i lirë të zgjedhë mjetet me të cilat do të përmbushë detyrimin e tij ligjor sipas nenit 46 të konventës, me kusht që këto mjete të jenë të pajtueshme me përfundimet e caktuara në vendimin e Gjykatës (shihni *Scozzari dhe Giunta kundër Italisë* [GC], nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, GJEDNJ 2000-VIII). Gjykata vëren fillimisht se legjislacioni aktual mbi pronësinë është ndryshuar shpesh, të paktën shtatë herë gjatë periudhës 2004-2010. Ndërsa ndryshimet legjislative mund të reflektojnë një situatë të përmirësuar, kompleksiteti i dispozitave legjislative, ndryshimet e shpeshta të tyre, si dhe praktika e papajtueshme gjyqësore që rezultojnë nga to, do të kontribuojnë në mënyrë të pashmangshme në një mungesë të përgjithshme të sigurisë juridike. Shteti i paditur duhet të shmangë ndryshimet e shpeshta të legjislacionit dhe të shqyrtojë me kujdes të gjitha implikimet ligjore dhe financiare përpara se të paraqesë ndryshime të mëtejshme.

111. Siç u pranua nga qeveria në planin e saj të veprimit, autoritetet nuk kishin informacion të saktë dhe të besueshëm në lidhje me numrin e përgjithshëm të vendimeve administrative që njihnin të drejta të pronësisë dhe dhënien e kompensimit, sipas rastit, të cilat ishin miratuar që prej vitit 1993. Ekzistenca e të dhënave të sakta që duhet të reflektojnë edhe ndryshimet e bëra me anë të rishikimit gjyqësor, do t'i jepte mundësinë autoriteteve të llogarisnin dhe analizonin faturën e përgjithshme të kompensimit, si dhe implikimet financiare të mekanizmit të kompensimit.

112. Përgatitja e një baze të dhënash dhe llogaritja e faturës globale të kompensimit duhet të shoqërohet nga një skemë e qartë kompensimi e hartuar me kujdes. Skema e kompensimit e cila nuk duhet të ketë procedura të ngarkuara përputhshmërie, për shembull detyrimin që një ankues të aplikojë për kompensim në vitin e ardhshëm në rast të një kërkesë të suksesshme në një vit pararendës, duhet të marrë në konsideratë parimet e praktikës së Gjykatës në lidhje me zbatimin e nenit 6 § 1 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 (shihni paragrafët 90-92 më lart).

113. Më tej, Gjykata vëren se skema e kompensimit duhet të trajtojë përfundimet e nxjerra sipas nenit 13 të konventës (shihni paragrafët 75-84 më lart). Në veçanti, ajo thekson ngarkesën tejet të rënduar në buxhetin e shtetit që përfaqëson kompensimi financiar. Përfundimet e mësipërme kërkojnë qartë një rishqyrtim të modaliteteve për pagesën e kompensimit financiar që zbatohet aktualisht. Rishikimi dhe përditësimi i hartave të vlerës duhet t'i nënshtrohet kriterëve transparente dhe shpjeguese, duke marrë parasysh zhvillimin e tokës dhe luhatjet e tregut. Gjykata nxit autoritetet me prioritet që të fillojnë shfrytëzimin e formave të tjera alternative të kompensimit të parashikuara nga ligji për pronësinë i vitit 2004, të cilat eventualisht do të lehtësonin presionin ndaj buxhetit dhe/ose do të paraqisnin mënyra të tjera kompensimi.

114. Procesi i vendimmarrjes për llojin e kompensimit që do të jepet kërkon transparencë dhe efikasitet maksimale, me synim rritjen e besimit të publikut. Do të ishte në interes të përgjithshëm që rezultatet të bëheshin publike dhe të shpërndaheshin përmes mjeteve të ndryshme, të aksesueshme të komunikimit. Është thelbësore që vendimet e autoriteteve të përmbajnë arsye të qarta dhe të mjaftueshme dhe t'i nënshtrohen rishikimit gjyqësor në rast mosmarrëveshjeje.

115. Procesi i kompensimit të ish-pronarëve për shkak të ligjeve për pronësinë duhet të

karakterizohet nga kompensimi i ish-pronarëve në bazë të ligjit të legalizimit. Në lidhje me këtë të fundit, shteti i paditur mund të rishqyrtonte rritjen e pjesës së kostos që legalizimi i ka sjellë ankuesve në masën që do të ishte i aftë të rregullonte kompensimin financiar të paguar ish-pronarëve. Nga ana tjetër, shteti i paditur duhet të garantojë ekzistencën e një sistemi transparent dhe efektiv të regjistrimit të pronave, duke përfshirë të dhëna të sakta, të unifikuara hartografike, me qëllim mundësimin, thjeshtimin dhe lehtësimin e transaksioneve të ardhshme ligjore.

116. Krejt në ndryshim nga propozimet në planin e veprimit të qeverisë që nuk kishte përmendur afate konkrete, Gjykata nuk mund të theksojë mjaftueshëm rëndësinë e caktimit të afateve realiste, statute dhe detyruese në lidhje me çdo hap të procesit. Shtyrjet e shpeshta të afateve, siç ka ndodhur deri tani, nuk kontribuojnë në një zgjidhje të shpejtë të problemeve të identifikuar dhe dëmtojnë më tej besimin e publikut.

117. Është e rëndësishme që, me qëllim garantimin e zbatimit efektiv të masave të përgjithshme, në dispozicion të autoriteteve kompetente të vihen burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale dhe të garantohet bashkërendimi midis institucioneve të ndryshme, me synim shkëmbimin e informacionit. Sa herë që të jetë e mundur, autoritetet mund të shqyrtojnë mundësinë e shkurtimit të burimeve, duke bashkuar institucione të ndryshme, me qëllim shmangien e mbivendosjeve dhe zvogëlimin e kostove dhe shpenzimeve operative. Krijimi i strukturave të reja institucionale nuk duhet të konsiderohet si një shtresë tjetër e procesit por duhet të justifikohet plotësisht.

118. Gjykata çmon se shkalla e problemit dhe masat e sugjeruara më lart, mbi një bazë tërësisht treguese, së bashku me nevojën për zgjidhje të plotë dhe praktike, mund të trajtoheshin më mirë, nëse do t'i nënshtroheshin diskutimeve të gjera publike, me qëllim grumbullimin e një perceptimi të gjerë rreth nivelit të kompensimit që shteti pritet të paguajë realisht dhe formave të ndryshme të kompensimit.

(d) Procedura e mëtejshme që duhet të ndiqet në çështje të ngjashme para kësaj Gjykate

119. Në lidhje me procedurën që duhet të ndiqet në çështje të ngjashme, Gjykata çmon të nevojshme të bëjë ndryshimin midis çështjeve tashmë të depozituara pranë Gjykatës dhe atyre që mund të paraqiten në të ardhmen.

120. Gjykata do të shtyjë procedimet në lidhje me të gjitha kërkesat e reja të depozituara pranë saj pas dhënies së këtij vendimi në të cilin ankuesit ngrenë ankime të diskutueshme që lidhen vetëm me moszbatimet e zgjatura të vendimeve të formës së prerë për pronësinë për ekzekutimin e të cilave shteti është përgjegjës, duke përfshirë kërkesat në të cilat janë ngritur edhe ankimet që pretendojnë mungesë të mjeteve ligjore efektive në lidhje me këtë moszbatim. Shtyrja do të jetë efektive për një periudhë prej 18 muajsh pasi vendimi aktual të marrë formë të prerë. Si rrjedhojë, ankuesit në këto çështje do të informohen.

121. Megjithatë, Gjykata vendos të ndjekë një rrugë tjetër në lidhje me kërkesat e depozituara përpara dhënies së këtij vendimi. Procedurat në lidhje me të gjitha çështjet e regjistruara nuk do të shtyhen. Ato do të vazhdojnë të shqyrtohen pasi ky vendim të marrë formë të prerë, pa cenuar asnjë moment kompetencën e Gjykatës për të shpallur të papajtueshme ndonjë çështje të tillë ose për ta hequr nga lista pas një zgjidhjeje miqësore ndërmjet palëve ose zgjidhjes së çështjes me mjete të tjera në pajtim me nenet 37 ose 39 të konventës ose nenin 62a të rregullores së Gjykatës.

VI. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

122. Neni 41 i konventës parashikon si më poshtë:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e palës së lartë kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

1. Parashtrimet e palëve

123. Ankuesit u bazuan në raportet e vlerësimit të ekspertëve dhe bënë kërkesat e mëposhtme në lidhje me dëmin monetar dhe jomonetar.

Numri dhe emri i ankimit	Dëmi monetar	Dëmi jomonetar
604/07 <i>Manushaqe Puto</i>	1,440,000 euro në lidhje me vlerën e pronës (5,000 metra katrorë x 288 euro/metri katror);	25,000 euro

	720,000 euro në lidhje me humbjen e shfrytëzimit të fitimeve;	
43628/07-Dani	343,750 euro në lidhje me vlerën e pronës (1,375 metra katrorë x 250 euro/metri katror);	70,000 euro
	305,900 euro në lidhje me parcelën e tokës 3,800 metra katrorë (3800 metra katrorë x 80.5 euro/metri katror);	
46684/07-Ahmatas dhe të tjerë	305,900 euro në lidhje me parcelën e tokës 3,800 metra katrorë (3,800 metra katrorë x 80.5 euro/metri katror)	80,000 euro
	2,545,590 lekë (18,372 euro) në lidhje me parcelën e tokës 59,546 metra katrorë në lidhje me të cilën janë lëshuar obligacionet	
34770/09-Muka	105,000,000 lekë (790,000 euro) në lidhje me parcelën e tokës 660 metra katrorë;	Asnjë
	79,000,000 lekë (585,000 euro) në lidhje me parcelën e tokës 622 metra katrorë;	

124. Qeveria kundërshtoi pretendimet e ankuesve dhe i ftoi ata të aplikojnë për kompensim financiar në përputhje me VKM-të.

2. Vlerësimi i Gjykatës

125. Duke marrë parasysh natyrën joefektive të sistemit aktual të kompensimit dhe në veçanti, faktin se kanë kaluar mbi 15 vjet që prej fillimit të dhënies së kompensimit, Gjykata, pa cenuar zhvillimet e mundshme të ardhshme në lidhje me mekanizmin e kompensimit, çmon të arsyeshme t'i japë ankuesve një shumë që do të përfaqësonte një zgjidhje përfundimtare dhe shteruese të ankimeve të tyre. Në këtë kuadër, Gjykata rritetëson përfundimet e saj në çështjen *Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (shpërblimi i drejtë), nr. 35720/04 dhe 42832/06, §§ 33-39, 7 dhjetor 2010) në lidhje me mënyrën e llogaritjes së dëmit monetar dhe jomonetar.

126. Duke marrë në konsideratë materialin në zotërim të saj dhe marrjen e vendimit mbi baza të barabarta, Gjykata çmon të arsyeshme të akordojë shpërblimet e mëposhtme në lidhje me dëmin monetar dhe jomonetar:

Numri dhe emri i ankimit	Dëmi monetar dhe jomonetar
604/07-Manushaqe Puto	1,000,000 euro
43628/07-Dani	280,000 euro
45584/07-Ahmatas dhe të tjerë	352,400 euro
34770/09-Muka	1,360,000 euro

B. Kostot dhe shpenzimet

1. Parashtrimet e palëve

127. Ankuesit, të cilët paraqitën fatura, ngritën pretendimet e mëposhtme në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

Numri dhe emri i ankimit	Procedimet e brendshme	Procedimet e Strasburgut
604/07-Manushaqe Puto	Asnjë	4,075 euro
43628/07-Dani	2,940 euro	
46684/07-Ahmatas dhe të tjerë	5,035 euro	
34770/09-Muka	Asnjë	

128. Qeveria parashtroi se ankuesit nuk paraqitën fatura të detajuara. Ajo hodhi poshtë pretendimet e ankuesve për kosto dhe shpenzime, si të tepruara dhe të paarsyeshme.

2. Vlerësimi i Gjykatës

129. Sipas praktikës së Gjykatës, një ankues ka të drejtën e riimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm në masën që është përcaktuar se ato janë shkaktuar në të vërtetë dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme në raport me sasinë (shihni *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, § 72, 29 shtator 2009). Për këtë qëllim, neni 60 § 2 dhe 2 i rregullores së Gjykatës përcakton se ankuesit duhet të bashkëlidhin me ankimet e tyre për shpërblim të drejtë “çdo dokument përkatës mbështetës” dhe në pamundësi të kësaj, Gjykata “mund të rrëzojë pretendimet tërësisht ose pjesërisht”.

130. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se ankuesit në ankimet nr. 604/07 (*Manushaqe Puto*), 43628/07 (*Dani*) dhe 46684/07 (*Ahmatas dhe të tjerë*) u përfaqësuan nga i njëjti avokat. Faktet e këtyre çështjeve ishin të drejtpërdrejta në lidhje me zbatimin e procedimeve të brendshme dhe sipas konventës. Parashtrimet e tyre pranë kësaj Gjykate ishin pothuajse të njëjta. Për më tepër, shumica e kostove dhe shpenzimeve të pretenduara nuk ishin të arsyeshme në raport me sasinë. Si përfundim, Gjykata vendos të akordojë 1,000 euro në lidhje me secilin prej tri ankimeve të mësipërme.

131. Gjykata nuk jep kompensim për kostot dhe shpenzimet në lidhje me ankimet nr. 34770/09 (*Muka*) në mungesë të ankimeve të bëra nga ankuesit.

C. Kamatëvonesa

132. Gjykata çmon të nevojshme që norma e kamatëvonesës duhet të bazohet në normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane, të cilës duhet t’i shtohen tri pikë për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT

1. Vendos të bashkojë ankimet;
2. Vendos të bashkojë me themelet e ankimit sipas nenit 13 të konventës, kundërshtimin e qeverisë në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme juridike;
3. Shpall kërkesat të pranueshme;
4. Gjykon se ka pasur një shkelje të nenit 13 të konventës dhe për pasojë, rrëzon kundërshtimin e qeverisë në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme ligjore;
5. Gjykon se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të konventës;
6. Gjykon se shteti i paditur duhet të marrë, brenda tetëmbëdhjetë muajve nga data në të cilën vendimi ka marrë formë të prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të konventës, masa për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të garantuara nga neni 6 § 1 i konventës dhe neni 1 i protokollit nr. 1, në kontekstin e të gjitha çështjeve të ngjashme me çështjen në fjalë, në përputhje me parimet e konventës të vendosura në praktikën e Gjykatës;
7. Gjykon se do të shqyrtojë, nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të konventës, çështjet e depozituara përpara dhënies së vendimit në fjalë, pa cenuar në asnjë moment kompetencën e Gjykatës për të shpallur të papranueshëm ndonjë çështje të tillë ose për ta hequr nga lista pas një zgjidhjeje miqësore ndërmjet palëve ose zgjidhjes së çështjes me mjete të tjera, në përputhje me nenet 37 ose 39 të konventës;
8. Gjykon se në pritje të marrjes së masave të mësipërme, Gjykata do të shtyjë, për një periudhë prej tetëmbëdhjetë muaj nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të konventës, procedurat në të gjitha çështjet e ngjashme me çështjen në fjalë, të cilat ishin paraqitur pas dhënies së këtij vendimi, pa cenuar kompetencën e Gjykatës në çdo kohë për të shpallur të papranueshëm ndonjë çështje të tillë ose për ta hequr nga lista pas një zgjidhjeje miqësore ndërmjet palëve ose zgjidhjes së çështjes me mjete të tjera në përputhje me nenet 37 ose 39 të konventës;
9. Gjykon
 - (a) Se shteti i paditur duhet t’i paguajë ankuesve solidarisht, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të konventës, shumat e mëposhtme që duhet të konvertohen në monedhën kombëtare me normën e zbatueshme në datën e shlyerjes:
 - i) 1,000,000 euro (një milion euro) plus çdo taksë që mund të jetë e kërkueshme, për dëmin monetar dhe jomonetar që lidhet me kërkesën nr. 604/07;
 - ii) 280,000 euro (dyqind e tetëdhjetë mijë euro) plus çdo taksë që mund të jetë e kërkueshme, për dëmin monetar dhe jomonetar që lidhet me kërkesën nr. 43628/07;

iii) 352,400 euro (treqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind euro) plus çdo taksë që mund të jetë e kërkueshme, për dëmin monetar dhe jomonetar që lidhet me kërkesën nr. 43628/07;

iv) 1,360,000 euro (një milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë euro) plus çdo taksë që mund të jetë e kërkueshme, për dëmin monetar dhe jomonetar që lidhet me kërkesën nr. 34770/09;

v) 1,000 euro (një mijë euro) për kostot dhe shpenzimet që lidhen me kërkesën nr. 604/07;

vi) 1,000 euro (një mijë euro) për kostot dhe shpenzimet që lidhen me kërkesën nr. 43628/07;

vii) 1,000 euro (një mijë euro) për kostot dhe shpenzimet që lidhen me kërkesën nr. 46684/07;

(b) Se nga mbarimi i periudhës së lartpërmendur prej tre muaj deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm ndaj shumave të mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë për qind.

10. Rrëzon pjesën e mbetur të kërkesës së ankuesve për shpërblim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 31 korrik 2012, sipas nenit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës

Lech Garlicki
President

Lawrence Early
Regjistrues

SHTOJCË

A. Statistika në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave

Më 30 qershor 2009 qeveria siguroi një listë të 1,194 ankuesve të cilët kishin aplikuar për kompensim financiar gjatë periudhës 2005-2008. Dhënia e kompensimit financiar bazohej në hartat e vlerësimit të pronës. Lista përmbante disa ankues, të cilët kishin marrë vendimet e Komisionit fillimisht në vitin 1993 dhe 1994, por nuk u ishte dhënë kompensim financiar pasi parcelat e tokave të tyre u ishin kthyer pjesërisht. Në lidhje me ankuesit e tjerë, të cilëve nuk u ishte dhënë kompensim financiar për vendimet e Komisionit të vitit 1993 dhe 1995, qeveria e shpjegoi me anë të mosrespektimit nga ana e ankuesve të kërkesave statutoire për paraqitjen e dokumenteve të kërkuara dhe mungesës së fondeve.

Më 19 maj 2010 qeveria ofroi statistikën e kombinuara të mëposhtme në lidhje me procesin e kompensimit financiar.

Nr.	Viti	Shuma totale e kompensimit	Numri i ankimeve	Numri i përfituesve	Vendndodhja gjeografike
1	2005	209,215,623 lekë	103	28	Tiranë
2	2006	297,067,149 lekë	251	59	Tiranë, Kavajë
3	2007	499,999,994 lekë	468	119	Në të gjithë vendin
4	2008	497,518,493 lekë	740	162	Në të gjithë vendin
5	2009	1,250,725,155 lekë		209	Në të gjithë vendin
6	2010	21,000,000 dollarë amerikanë		Në proces	Në të gjithë vendin

Për më tepër, qeveria ofroi shifrat e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i çështjeve	Numri total
1	Numri i ankimeve të pazgjidhura për kërkim të të drejtave të pronësisë, kthimit dhe kompensimit të tyre	40,803
2	Numri i ankimeve të drejtat për pronësi të të cilave, janë njohur	28,899
3	Numri i ankimeve në pritje të kompensimit të plotë [deri tani nuk është kryer asnjë kompensim financiar i pjesshëm]	14,953
4	Numri i ankimeve në pritje të kompensimit të plotë, në lidhje me të cilat është dhënë kompensim financiar [pjesërisht]	9,065
5	Numri i ankuesve që kanë aplikuar për kompensim financiar	1,460
6	Numri i ankimeve që kanë marrë kompensim financiar	368
7	Numri i ankuesve që kanë marrë kompensim të plotë financiar (madhësia e pronës deri në 200 metra katrorë)	128

Më 22 shkurt 2012, qeveria miratoi raportin vjetor mbi shpërndarjen e kompensimit financiar gjatë vitit 2011 (vendimi nr. 128). Sipas raportit, në 2011 ka pasur 1,012 ankime për kompensim financiar nga të cilat 107 ankuesve u ishte dhënë kompensim financiar në një shumë totale prej 665,999,275 lekë, të barasvlershme me 4,684,000 euro ("euro"); 46 ankime u rrëzuan dhe pjesa e mbetur prej 859 nuk u shqyrtua për shkak të mungesës së fondeve.

B. Statistikat në lidhje me procesin e legalizimit

Raporti i progresit i vitit 2008 mbi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim përcaktonte, ndër të tjera, se:

“2.2 Të drejtat e pronësisë

[...]

Në periudhën 2006-2008 në të gjithë vendin ishte identifikuar një numër i përgjithshëm prej 350,000 ndërtime informale dhe u krijua një bazë të dhënash me anë të fotografive ajrore. Vetëdeklarimi vullnetar ka përfunduar në lidhje me 270,595 ndërtime informale (...). Mbi bazën e statistikave dhe pas përpunimit të të dhënave, rezultoi se 29% të ndërtesave informale ishin ngritur në parcela toke që i përkisnin pronarëve të ligjshëm, 24 % [të ndërtesave informale ishin ngritur] në tokë shtetërore dhe 35 % [të ndërtesave informale ishin ndërtuar në parcelën e tokës së ndërtuesit. Nuk ka informacion në lidhje me 14 % [të ndërtesave informale].]

Më 30 qershor 2009 qeveria konfirmoi se ka pasur 350,000 ndërtime pa leje që do t'i nënshtroheshin procesit të legalizimit. Në periudhën 2008-2009 autoritetet dhanë kompensim në shumën e barasvlershme prej 34,500,000 euro në lidhje me 1,234 ish-pronarë. Mbi 36,640 objekte u legalizuan, të cilat mbulonin një sipërfaqe prej 12,066,188.43 metra katrorë.

Një përmbledhje e Bankës Botërore i vitit 2011 për mbrojtjen e të drejtave të pronave të patundshme në Shqipëri: një sfidë e vazhdueshme” përcaktonte, ndër të tjera, se (pa referenca):

“...vetëm 874 pronarë të shpronësuar kanë marrë kompensim në lidhje me procesin e legalizimit dhe 1,300 çështje të tjera i janë transferuar Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (...) ndërsa një numër shumë më i madh çështjesh janë në pritje të kompensimit. Shifrat e nxjerra nga ALUIZNI dhe të marra nga [agjencia] tregojnë se rreth 4.5 miliardë lekë (mbi 30 milion euro) duhet t'i paguhen 1,460 pronarëve të pronave të shpronësuar, kërkesat e të cilëve janë aprovuar me vendim qeverie. Deri tani ALUIZNI ka grumbulluar 30 milion euro në tarifa nga të cilat gjysma i janë paguar për kthim ankuesve. Kjo është më e ulët se shumta e kërkuar për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, që nënkupton pjesën më të madhe të kompensimit të kërkueshëm, rrjedhimisht duhet të paguhet nga burimet buxhetit. Pavarësisht nga kjo mungesë, ndryshimet në [ligjin] e legalizimit u miratuan në tetor 2009, duke i lejuar ankuesve të paguajnë deri në gjysmën e koston së legalizimit që ndryshe përdor fatura të pavlefshme të lëshuara sipas një skeme privatizimi të viteve '90. Pranimi i faturave mund të privojë shtetin nga të ardhura të konsiderueshme që mund të ishin përdorur për të kompensuar pronarët e shpronësuar.”

Raporti mbi shpërndarjen e kompensimit financiar gjatë vitit 2011 përmendte se gjatë periudhës gusht 2010-shkurt 2011, 1,877,092,628.87 lekë dhe ekuivalenti prej 13,142,800 euro është shpërndarë si kompensim për ish-pronarët si rezultat i procesit të legalizimit. Shumat financiare janë përdorur për të paguar kështet e para, të dyta ose të treta në përputhje me alokimet e bëra në bazë të VKM-ve gjatë viteve të ndryshme.